



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA KLOS**  
**NJËSIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE NDIHMËS SË HUAJ**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Klos më: \_\_\_\_, \_\_\_\_, 2022

**RELACION**

**Për Këshillin e Bashkisë Klos.**

Autorizim për Kryetarin e Bashkisë Klos, Ilmi Hoxha, për të nënshkruar kontratën, për grantin e fituar me Letrën e Njoftimit Nr. **156 Prot**, datë **25. 07. 2022** dhe me **Nr. Reference të aplikimt: EU4M-CFP-2-A7** ndërmjet Bashkisë Klos dhe Komisionin e Bashkimit Evropian me thirrjen e dytë të skemës së granteve “BE për Bashkitë”.

Të nderuar këshilltarë!

Bazuar në ligjin Nr **139/2015 datë 17/12/2015**, “Për vetëqeverisjen Vendore”, Vendimin e Këshillit të Bashkisë me Nr **57 datë 24.12.2021** “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afat-Mesëm 2022-dhe të Buxhetit të vitit 2022”:

Po ju informojmë me anë të këtij relacioni se Bashkia Klos ne bashkëpunim me organizatën VIS ALBANIA, sipas njoftimit me Nr. **156 Prot**, datë **25. 07. 2022** dhe me **Nr. Reference të aplikimt: EU4M-CFP-2-A7**, është shpallur fituese me projekt propozimin “**First STEPS: Support To Environment, Participation and Sport in the Municipality of Klos**”, “**HAPAT E PARË: Mbështetje për Mjedisin, Pjesëmarrjen dhe Sportin në Bashkinë Klos**” në kuadër të thirrjes së dytë të granteve “BE për Bashkitë”.

Ky project financohet nga Bashkimi Evropian në bashkëfinansim me Bashkinë Klos, e cila është partner lider në këtë projekt.

Projekti do të zbatohet për një periudhë **9-mujore**.

Projekti “**First STEPS: Support To Environment, Participation and Sport in the Municipality of Klos**”/ “**HAPAT E PARË: Mbështetje për Mjedisin, Pjesëmarrjen dhe Sportin në Bashkinë Klos**” synon krijimin e një këndi lojërash të gjelbërt publik që mund të përdoret si nga kopshti i fëmijëve lokal ashtu edhe nga i gjithë komuniteti. Prania e një bashkëpunimi aktiv me një OJF me eksperiencë ndërkombëtare, por në të njëjtën kohë edhe me një eksperiencë të gjatë në kontekstin rural si VIS Albania, është një mbështetje e rëndësishme për Bashkinë Klos në zbatimin e veprimeve në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike lokale. me fokus në fuqizimin e të rinjve, mbrojtjen e mjedisit, gjelbërimin e qytetit si dhe përmirësimin e aksesit dhe cilësisë së arsimit, sportit dhe kulturës, siç sugjeron Cfp. Krijimi i një këndi lojërash/parku publik do të përmirësojë infrastrukturën publike të Bashkisë dhe në të njëjtën kohë do të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm civil në drejtim të kujdesit ndaj fëmijëve dhe fuqizimit të grave, si dhe stilit të shëndetshëm të jetesës.

**Qëllimi i përgjithshëm** i projektit është të kontribuojë në rritjen e mirëqenies sociale të Bashkisë Klos nëpërmjet futjes së formave të reja të përfshirjes së komunitetit, aktiviteteve të shëndetshme në kohën e lirë dhe menaxhimit të përbashkët të burimeve.

**Objektivi specifik:** Të mbështetet një zhvillim lokal më gjithëpërfshirës duke i shtuar infrastrukturës lokale një shesh lojrash komunitare publike dhe miqësore me mjedisin.

**Rezultati 1:** Bashkia Klos pasurohet me një hapësirë të re të gjelbër në ambjent të hapur për banorët e saj.

**Rezultati 2:** Fëmijët e kopshtit lokal mund të disponojnë kënd lojërash të hapur të sigurt dhe të gjelbër gjatë orëve didaktike.

**Rezultati 3:** Rritet ndjeshmëria e të gjithë komunitetit të Klosit për ndikimin pozitiv të takimeve sociale dhe hapësirave të sigurta në ambjent të hapur.

**Rezultati 4:** Oferta kulturore dhe sportive e jetës publike në Klos pasurohet me aktivitete të reja në ambjente të hapura.

### **Grupet përfituese:**

- **Fëmijët e vegjël**, që do të kenë një vend të sigurt për të përjetuar aktivitete të reja didaktike gjatë orarit të kopshtit dhe gjithashtu mundësinë e ndjekjes së marrëdhënieve të miqësisë edhe jashtë shkollës, si moshatarët e tyre në qytete të tjera shqiptare;

- **Mësuesit e kopshtit**, që do të jenë pjesë e aktiviteteve edukative për të zbuluar të gjitha mundësitë që ofron këndi i lojërave me qasje didaktike;

- **Të rinjtë dhe adoleshentët** më në fund do t'i referohen një vendi të sigurt ku të takohen dhe të marrin inpute pozitive, në vend që të mësojnë që në moshë shumë të re t'i referohen bareve dhe pubeve private;

- **Gratë dhe vajzat e reja** mund të ndihen të pa gjykuara dhe të mirëpritura kur kalojnë kohë jashtë shtëpisë, takohen së bashku, ndajnë përvojën dhe besimin pa u shqetësuar për gjykimin ose neglizhencën e mundshme, ndërkohë që fëmijët e tyre janë duke luajtur të sigurt;

- **Familjet në përgjithësi** do të përfitojnë nga aktivitetet e ndryshme rekreative dhe edukative të lidhura me këndin e lojërave.

### **Angazhimi i ofruar nga Komisioni i bashkimit Evropian është:**

Buxheti total i projektit: **48.385 euro**

Kontributi i kërkuar i BE-Së: **43.465 euro.**

### **Kontributi i Bashkisë Klos:**

- Të implementojë në bashkëpunim me partnerët e projektit aktivitetet e parashikuara.
- Të kalojë në rolin e partnerit lider fondet e parashikuara tek partneri tjetër i projektit-VIS ALBANIA
- Të mirëmbajë ambjentet dhe pajisjet që do të blihen në kuadër të projektit.

- Të përdorë këto ambiente dhe pajisje në dobi të fëmijëve, të rinjve, grave dhe të gjithë komunitetit lokal.

- Të bashkëfinancojë 10% të shumës totale të projektit (4.920 euro)

Plani i aktiviteteve për periudhën 9 mujore të zbatimit të projektit **“First STEPS: Support To Environment, Participation and Sport in the Municipality of Klos”**, **“HAPAT E PARË: Mbështetje për Mjedisin, Pjesëmarrjen dhe Sportin në Bashkinë Klos”**, do të zbatohet nga Bashkia Klos, ku janë përgjegjës Sektori i Planifikimit dhe Ndjekjes dhe Ndjekjes së Investimeve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Çështjeve Juridike dhe Shërbimeve Financiare, Sektori i Turizmit, Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sportit dhe Shëndetësisë, Njësia e Koordinimit të IE+ Ndhmës së Huaj dhe organizata partnere, VIS ALBANIA.

Bashkangjitur do të gjeni letrën e Njoftimit: Komisioni i Bashkimit Evropian me thirrjen e dytë të skemës së granteve “BE për Bashkitë” me **Nr. 156 Prot**, datë **25. 07. 2022** dhe me **Nr. Reference të aplikimit: EU4M-CFP-2-A7**, në kuadër të projekt- propozimit **“First STEPS: Support To Environment, Participation and Sport in the Municipality of Klos”/ “HAPAT E PARË: Mbështetje për Mjedisin, Pjesëmarrjen dhe Sportin në Bashkinë Klos”**.

**Hartuesi**

**Aurela Burreli**

Konceptoi & Printoi: A. Burreli

Nr. kopjeve: 3(tre)

Datë: 26.07.2021